



SUCCESS STORY

Një frymë e re në shkollat e Kosovës

Komunitetet mbliohen për të renovuar klasat.



Fëmijët hyjnë në klasën e renovuar për herë të parë



Mësuesi dhe një prind duke punuar së bashku



Një gjysh kontribuon

"Unë do të doja të falënderoj USAID-in për mobilizimin e komunitetit tim për të marrë përsëri vullnetin për të përmirësuar mundësitë e arsimimit për gjeneratën e ardhshme", tha Valbone Halimi, drejtoreshë e shkollës fillore "Halil Alidema"

Lufta që rrënoi Kosovën në fund të viteve 1990 mori një kthesë shkatërruese në infrastrukturën e vendit, edhe shkollat nuk u përjashtuan. Madje në vitin 2010, kur USAID-i prezantoi Programin për Arsim Themelor, shumica e klasave ngjasonin në dhoma të hapura me shumë pak materiale edukative të cilat mund të gjenden çdo kund në Evropë.

Që nga përfundimi i luftës, rindërtimi dhe modernizimi i sistemit arsimor publik ka qenë kryesisht i varur nga ndihmat e jashtme, dhe në një masë nga qeveria e Kosovës, gjë që shtyri USAID-in të vendos për të ndihmuar komunitetet që të kenë një rol më të madh në përmirësimin e mundësive të arsimit për fëmijët e tyre.

USAID prezantoi iniciativën për "rindërtimin e klasës" që do të realizohet përmes angazhimit të drejtpërdrejtë të komunitetit, i cili në vitin 2011 radio televizioni i Kosovës (RTK) e transmetoi për një seri prej gjashtë episodave, ku u shfaqën përfaqësuesit e USAID-it krahas krahas duke punuar me anëtarët e komunitetit. Ata demonstuan se si një mjedis atraktiv i mësimit mund të krijohet me një kosto relativisht të ulët me përfshirjen aktive të prindërve dhe pjesëtarëve të tjerë të komunitetit.

Pas transmetimit të serive, USAID ftoi edhe shkolla të tjera të aplikojnë për mbështetje rreth organizimit të tyre për "rindërtimin e klasës," zhvillimin e një libri udhërrëfyes dhe ofroi trajnime në pjesëmarrjen e komunitetit për bordet drejtuese të shkollës për të inkurajuar ata të aplikojnë këto renovime në shkolla të reja. Me trajnim themelor dhe financim nga USAID-i dhe pjesëmarrjen aktive të anëtarëve të komuniteteve, mbi 100 shkolla janë renovuar në më pak se tri vjet, dhe shumë prej tyre morën iniciativën edhe pa mbështetjen e USAID-it.

Për t'i prirë punës së renovimit në çdo shkollë, USAID-i siguroi materiale themelore siç janë ngjyra dhe pjesët e sipërme të bankave, si dhe mundësoi një takim fillestar të personelit të shkollës me komunitetin lokal. Shumë shkolla vazhduan renovimin e klasave tjera pa asnjë mbështetje nga programi. Disa vazhduan renovimin e gjithë shkollës, duke përfshirë korridoret dhe hapësirat tjera. Puna përfshinte renovimin dhe ngjyrosjen e mobileve, renovimin dhe ngjyrosjen e mureve dhe tavaneve, renovimin e dyshemesë dhe poashtu rindërtimin e sistemeve elektrike.

Në dhjetor 2012, Programi për Arsim Themelor i USAID-it organizoi ceremoninë e shpërndarjes së çmimeve për të festuar përfundimin e mbi 50 klasave të renovuara. Gjatë kësaj ngjarjeje, mësimitdhënësit dhe drejtorët e shkollave dëshmuar ndikimin që programi pati në interesimin e prindërve dhe përfshirjen e komunitetit.

"Unë do të doja të falënderoj USAID-in për fuqizimin e komunitetit tim për të marrë përsëri vullnetin për të përmirësuar mundësitë e arsimimit për gjeneratën e ardhshme", tha Valbone Halimi, drejtoreshë në shkollën fillore "Halil Alidema" nga fshati i vogël i Pozheranit. Ajo tregoi fotografitë e shkollës së parë të fshatit, e ndërtuar nga bashkësia lokale në vitin 1905, dhe të fshatarëve duke gërmuar themelet për një shkollë më të madhe në vitet e '60-ta.

Për shkollën "Halil Alidema" si dhe në dhjetëra shkolla të tjera përrreth Kosovës, projekti për renovimin e klasave ndihmoi shumë në rigjenerimin e një fryme të vetë-besimit në mesin e komuniteteve të Kosovës dhe fuqizoi ata për të ndërtuar mundësitë e ofruara përmes ndihmës së jashtme.

Renovimi i klasave është vetëm një pjesë e Programit për Arsim Themelor të USAID-it, e cila është në partneritet pesë vjeçar me qeverinë e Kosovës e cila ka filluar në vitin 2010, e që ka për qëllim për të përmirësuar aftësitë e mësimitdhënësve dhe nxënësve si dhe përgatitjen profesionale të tyre për shekullin 21.